



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 609/2 prot.,

Datë 12.03.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:	Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ermal Gjoza” P.F. në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-94718-02-07-2024, me objekt: “Lende Djegese (Pelet)”, me fond limit 4,288,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19-02-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.
Ankimues:	Operatori ekonomik “Ermal Gjoza” P.F. me NIPT L26927601B dhe adresë Lagjja 1, Rruga Morava, Zona Kadstrale 1187, Nr. Pasurie 5/536, Bilisht, Korçë.
Autoriteti Kontraktor:	Bashkia Devoll Lagjia Nr. 1 Rruga “24 tetori” Nr.9, Bilisht Devoll

Në datën 10.03.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/3885, si dhe nr. protokollit 609/2024 datë 11.03.2024, i operatorit ekonomik “Ermal Gjoza” P.F për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-94718-02-07-2024, me objekt: “Lende Djegese (Pelet)”, me fond limit 4,288,000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 19-02-2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Devoll.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ermal Gjoza” P.F. nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”*, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Ermal Gjoza” P.F

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

-KVO ne daten 29.02.2024 nepermjet SPE i kërkoi ofertuesit “ERMAL GJOZA” Person Fizik, të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 te VKM-Nr. 285, datë 19.5.2021 “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK” (e ndryshuar), si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.. sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

-Operatori Ekonomik “ERMAL GJOZA” Person Fizik, ne date 01/03 2024 dorezoi dokumentacionin fizik prane institucionit Bashkia Devoll, ku nga verifikimet rezultoi se OE nuk ka paraqitur dokumenta per te provuar se permbush informacionin e Formularit te Vetedeklarimit, si me poshte;

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënua për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

**Autoriteti kontraktor, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, sipas përcaktimeve te nenit 92 te LPP*

-Në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe VKM-Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 12.03.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Kreshnik Ternova

Nënkryetar

Fiorent Zguro